



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
Nr : 04-353/01-61333
Data: 04.06.2025
P r i z r e n

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIROR KK – PRIZREN, me kërkesën e **Kabashi Holding Sh.P.K. dhe Kabashi 2 Sh.P.K. Prizren,** me të cilën pala ka kërkuar leje për: **vendosjen e trafostacionit 2XSn=1600kVA dhe grupimi për vendosjen e kablove në puseta egzistuese, shtritja e linjës së tensionit të lartë – sipas dokumentacionit teknik KEDS,** e në bazë të e në bazë të nenit 3 paragrafit 1, pika 1.27 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor me Nr.04/L-174 të Dt.31.07.2013, nenit 3.1.1,1.2,1.4,1.17,1.24, e në lidhje me nenin 4,1.2, si dhe nenin 5,1.1 si dhe nenin 14.1.2, të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110, dhe sipas Vendimit për miratimin HZK për periudhën 2022-2030 Nr.001-011-48192 të dt 31.03.2022, dhe të nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 27,44,46,47,48 të L.P.P.A nr.05/L-031 dt. 25.05.2016 merr këtë:

A K T V E N D I M

I LEJOHET : Kabashi Holding Sh.P.K. dhe Kabashi 2 Sh.P.K. Prizren, me të cilën pala ka kërkuar leje për: **vendosjen e trafostacionit 2XSn=1600kVA dhe grupimi për vendosjen e kablove në puseta egzistuese, shtritja e linjës së tensionit të lartë – sipas dokumentacionit teknik KEDS,** në rrugën Tirana pn.

- I. Të punohet sipas dokumentacionit të hartuar nga KEDS Sh.A. – Operatori I Sistemit të Shpërndarjes jep zgjidhjen teknike.
- II. Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin komunal në afat prej 8 ditësh.
- III. Hunjëzimi i objektit të bëhet sipas dokumentacioni teknik..
- IV. Investitori është i obliguar që punimet rreth infrastruktures të kryen sipas Aktvendimit të dhëna, kurse vend punimi natën të ndriqohet me dritë ashtu që të mundësohet qarkullimi i lirë i automjeteve dhe të këmbësorëve, kurse materialet të tjera duhet të menjahohen nga rruga ku janë kryer punimet.
- V. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12(dymbdhjetë) muajsh,duke llogaritur nga dita e marjes së të njejtës
- VI. Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vendpunishten menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme.
- VII. Pas përfundimit të ndërtimit investitori duhet të parashtojë kërkesën për pranimin teknik dhe marrjen e lejes për shfrytëzim.
- VIII. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12 (dymbdhjetë) muajsh,duke llogaritur nga dita e marjes së të njejtës.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim për plotësimin e dokumentacionin 04-353/01-61333 dt. 28.05.2025.
- Zgjidhjen teknike nga “KEDS” Sh.A. te dates 17.09.2024.

- Pëlqimin nga DSHP për infrastrukturën nëntoksore të lokacionit të datës 02.05.2025.
- Pëlqimi nga Hidroregjioni Nr.1946 të datës 03.06.2025.
- Pëlqimi nga PTK- Nr.151/2025 I datës 28.05.2025

P.S. Investitori është përgjegjës dhe obligohet që gjitha dëmtimet e mundshme të rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, PTK, KEDS-it, si dhe avari tjera të evitohet dhe të kthehet në gjendje të mëparshme me shpenzimet të veta dhe pa të drejtë kompensimi.

A r s y e t i m

Kabashi Holding Sh.P.K. dhe Kabashi 2 Sh.P.K. Prizren, është drejtuar këtij organi për marrjen e lejes për : vendosjen e trafostacionit 2XSn=1600kVA dhe grupimi për vendosjen e kablove në puseta egzistuese, shtritja e linjës së tensionit të lartë – sipas dokumentacionit teknik KEDS.

Duke shqyrtuar kërkesën e Investitorit si dhe dokumentacionin teknik dhe të shtojcave tjera të prezentuara së bashku me kërkesë vërtetohet se:

Në procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunorit profesional.

Në kuptim të dispozitave të lartë theksuara është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënie të lejes për : **vendosjen e trafostacionit 2XSn=1600kVA dhe grupimi për vendosjen e kablove në puseta egzistuese, shtritja e linjës së tensionit të lartë – sipas dokumentacionit teknik KEDS.** Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës MMPHI së-Prishtinë.


Bashkëpunetor profesional:



Shpresa Osmanollaj Krapa, inxh.dip.ark.



DREJTORI:


Pranverim Berisha, jur.